



INFORMATË BAZIKE:

Lajmëruesi i Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vejnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëri e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: www.kipred.org

LAJMËRUESI I DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

NËNTOR 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse synon t'u kundërvihet dezinformatave që e kanë në shënjestër Kosovën, përmes monitorimit në bazë mujore të botimeve të përzgjedhura mediale që botohen në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, ndërkaq, në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën i monitoron edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të lëshuara nga Kremli dhe Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë nëntorit 2020, Sputnik International i ka botuar 10 lajme, TASS-i 1, Unz-i 1, Russia Today 4, ndërsa Sputnik Serbia i ka botuar 155 lajme që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. Ndërkaq Russia Insider, News front, Meduza, The Duran, The Moscow Times dhe Pravda Report nuk e kanë botuar asnjë lajm që kishte të bënte me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese Ministria e Jashtme Ruse në ueb-sajtin e saj i kishte vendosur 2 postime të ndërlidhura me Kosovën.

Për shkak të numrit të madh të artikujve me përmbajtje dezinformuese të botuar nga këto media, në këtë botim janë analizuar vetëm artikujt me përmbajtjet dezinformuese më flagrante. Dezinformatat e lëshuara synojnë t'ia shkatërrojnë themelet shtetësisë së Kosovës duke iu referuar në mënyrë të vazhdueshme si "krahina e Kosovës dhe e Metohisë," dhe duke ia diskredituar udhëheqësinë dhe institucionet. Për më tepër, këto media janë të prirura që Kosovën ta paraqesin si vatër të ekstremizmit. Artikujt e përzgjedhur po ashtu synojnë ta shtrembërojnë të vërtetën për të kaluarën, duke i mohuar krimet e luftës dhe mizoritë e Serbisë në Kosovë dhe në Bosnje gjatë viteve 1990, si dhe duke i paraqitur serbët si viktimë gjatë këtyre luftrave, gjë kjo që ka për qëllim barazimin e viktimës me agresorin.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

Lajmërim i Dezinformatës 1

Titulli: Српским рукометашима забрањен улазак на Косово и Метохију [Hendbollsitëve serbë u ndalohet hyrja në “Kosovë e Metohi”], **Sputnik Serbia, 11 nëntor 2020.**¹

Artikulli nënvizon ndalesën për kalimin e kufirit të Republikës së Kosovës për ekipin hendbollistik Kurshumlia. “Anëtarët e Klubit Hendbollistik Kurshumlia janë kthyer nga kalimi administrativ i Merdares me “Kosovën e Metohinë”, ku ata është dashur ta luanin ndeshjen me Mokra Gorën.” Artikulli pohon rrejtshëm se “Lojtarëve dhe stafit profesional të klubit serb u është dhënë dokumenti ku thuhet se atletët nuk mund të hyjnë në Kosovë meqë konsiderohen si kërcënim për sigurinë e brendshme politike.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Artikulli pohon rrejtshëm se hendbollistët janë ndaluar nga kalimi i kufirit midis Kosovës e Serbisë, duke pohuar se ata kanë pranuar një dokument që thotë se “atletët nuk mund të hyjnë në Kosovë meqë ata konsiderohen si kërcënim për sigurinë e brendshme politike.” Lidhur me këtë, Policia e Kosovës ka reaguar duke deklaruar se “Më 12.11.2020, në ora 15:20, në kufirin në Merdare, Ekipi Hendbollistik ka ardhur për ta luajtur një ndeshje në Zutin Potok. “Bazuar në masat anti-COVID-19, atyre u është refuzuar hyrja në territorin e Republikës së Kosovës.”² Për më tepër, arsyeja e dytë është që lojtarët ndërkombëtarë me ekipet e vendeve të huaja janë të lejuara vetëm me lejen e federatave përkatëse sportive të Republikës së Kosovës.³ Prandaj, pretendimet e këtij artikulli, se hendbollistët u ndaluan nga hyrja në Republikën e Kosovës për shkak të arsyes se ata

¹ Српским рукометашима забрањен улазак на Косово и Метохију [Hendbollsitëve serbë u ndalohet hyrja në Kosovë e Metohi], <https://rs.sputniknews.com/politika/202011141123854727-srpskim-rukometasima-zabranjen-ulaz-na-kosovo-i-metohiju/>.

² Kosova kthen ekipin serb të hendbollit në kufi, <https://www.albinfo.at/kosova-kthen-ekipin-serb-te-hendnollit-ne-kufi1/>.

³ Ibid.

janë konsideruar si kërcënim për sigurinë e brendshme politike, nuk janë të vërteta, dhe janë në tërësi dezinformuese.

Lajmërim i Dezinformatës 2

Titulli: Почела велика битка Срба за сваки педаљ њихове земље на Косову [Ka filluar beteja e madhe e serbëve për çdo pëllëmbë të vendit të tyre në Kosovë], **Sputnik Serbia, 17 nëntor 2020.**⁴

Artikulli e nënvizon çështjen e pronës së komunitetit serb në Kosovë, duke pohuar se serbët janë duke u dëmtuar financiarisht dhe se prona e tyre është pa mbrojtje. Artikulli pretendon në mënyrë të rrejshme se “serbët i kanë dorëzuar rreth 70,000 kërkesa për kthimin e pronave të uzurpuara. Edhe pse ligji dhe drejtësia janë në anën e tyre, i ashtuquajtimi shtet i Kosovës është duke i vonuar paditë e tyre, ndërkohë që pronat e tyre është duke i shitur për asgjë.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Në të kaluarën ka patur raporte të ngjashme për problemet me pronën e serbëve në Kosovë. Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) ia ka dërguar një kërkesë lidhur me këtë çështje⁵ Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës (KPCVA). Përgjigja e KPCVA-së,⁶ ndër të tjera, thotë se:

- Pas fundit të luftës në Kosovë, Administrata e UNMIK-ut e ka themeluar Drejtorinë e Strehimit dhe të Pronave (HPD), e cila ishte autoriteti vendim-marrës për çështjet pronësore. Gjatë mandatit të këtij institucioni janë zbatuar 29,000 kërkesa të qytetarëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe pronat u janë kthyer qytetarëve.

⁴ Почела велика битка Срба за сваки педаљ њихове земље на Косову [Ka filluar beteja e madhe e serbëve për çdo pëllëmbë të vendit të tyre në Kosovë], https://cdn1.img.rs.sputniknews.com/img/111995/63/1119956375_0:134:3078:1800_1000x0_80_0_1_702b1241a0cb7011ae88d194e26e675f.jpg.webp.

⁵ Kërkesë të cilën KIPRED-i ia ka dërguar KPCVA-së, 2 tetor 2020.

⁶ Raport nga KPCVA, 7 tetor 2020.

- Pas fundit të mandatit të Drejtorisë së Strehimit dhe të Pronës (HPD), institucionet ndërkombëtre e kanë themeluar Agjencinë e Pronës së Kosovës (PAK), e cila po ashtu e ka patur mandatin për t'i adresuar çështjet pronësore. PAK-u i kishte trashëguar 42,000 çështje pronësore nga HPD-ja, të cilat u shqyrtuan dhe u vendosën nga Komisioni për Pretendimet Pronësore, dhe të gjitha këto pretendime janë zbatuar bazuar në kornizën ligjore në fuqi.
- Tre nga këto institucione, HPD, PAK dhe KPCVA, i kanë zbatuar urdhërat deportues për 8,229 prona të cilat ishin uzurpuar. Në ndërkohë, janë lëshuar 476 akuza penale për moslëshimin e pronës, apo për çështje të tjera.
- Aktualisht, në pritje janë urdhërat e lagimit për një total prej 61 pronash, 22 nga të cilat ndodhen në Veriun e Mitrovicës.
- Deri më sot, numri i pronave nën administrimin e KPCVA-së me vullnetin e pronarëve të tyre është 12,190. Ndërkohë, 8,237 është numri i pronave në skemën e qiradhënies, ku, deri më tash, pronarëve në kuadër të kësaj skeme u janë transferuar 5,279,154.00€.

Prandaj, duke i marrë parasysh faktet e përmendura më sipër, pretendimet e këtij artikulli janë dezinformuese dhe nuk qëndrojnë në realitet.

Lajmërim i Dezinformatës 3

Titulli: Dokazi na videlo: Lažno Kosovo — rak-rana Evrope u čijem temelju je strašan zločin [Të ndriçohen dëshmitë: Kosova e rrejshme – një plagë kanceri e Evropës në themel të së cilës është një krim i tmerrshëm], **Sputnik Serbia, 9 nëntor 2020.**⁷

Artikulli i nënvizon komentet e përbashkëta të Presidentit të Komitetit për Kosovën, Millovan Drecun, dhe avokatit Goran Petronijeviq, për gjykimin e komandantëve të ish-UÇK-së. Fillimisht Drecuni pohon: “E qartë, Thaçi pohon se nuk është fajtor, meqë vrasja e serbëve dhe e ushtarëve tonë, për të nuk është krim. Kjo fazë po ashtu tregon se nga akuza kundër Thaçit do të dalin më shumë akuza të tjera. Është e vështirë të thuhet nëse gjykata do të ketë fuqi për të paraqitur çkado qoftë dhe se si do të silltet.” Për më tepër, Drecuni thekson se shqiptarët kanë shpresuar në fitoren e Bidenit në SHBA, duke pohuar se “Ne vetëm do të shohim nëse do të ketë trysni politike dhe nëse zgjedhjet në Amerikë do të kenë ndonjë ndikim. Disa nga procedurat kanë treguar se gjykata i ka disa kalkulime.” Lidhur me Presidentin e Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, artikulli pohon “E qartë se ata e kanë përkrahur. Kjo është pse ata nuk kanë dashur që ata t’i ndjekin penalisht, meqë atëherë ata do të pyeteshin në vendet e tyre – kur i keni përkrahur ata? Kjo është pse Perëndimi i ka mbrojtur ata gjatë gjithë kohës, mirëpo diçka duket se ka ndryshuar. Pyetja është nëse Bideni do të përpiqet ta ndikojë gjykimin e Thaçit, apo të tërë gjyqit.” Në fundin e artikullit, duke aluduar në faktorin ndërkombëtar, Petronijeviqi pohon se “edhe përkundrejt akuzave kundër udhëheqësve të UÇK-së, udhëheqësit perëndimorë që i kanë ndihmuar ata nuk do të konsiderohen përgjegjës, edhe pse disa pjesë të strukturave të NATO-s, të BE-së dhe të Amerikës janë drejtpërdrejtë përgjegjëse.”

⁷ Dokazi na videlo: Lažno Kosovo — rak-rana Evrope u čijem temelju je strašan zločin [Të ndriçohen dëshmitë: Kosova e rrejshme – një plagë kanceri e Evropës në themel të së cilës është një krim i tmerrshëm], <https://rs-lat.sputniknews.com/analize/202011091123818517-dokazi-na-videlo-lazno-kosovo---rak-rana-evrope-u-cijem-temelju-je-strasan-zlocin-video/>.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Dhomat e Specializuara janë themeluar me vendimin e Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës ka votuar për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe të Zyres së Prokurorit të Specializuar,⁸ për të qenë në pajtim me obligimet ndërkombëtare lidhur me Raportin e 7 janarit 2011 të Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës.⁹ Mandati dhe jurisdiksioni i gjykatës është në krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera sipas ligjit të Kosovës, të cilat janë filluar apo janë kryer në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 nga, ose kundër, qytetarëve të Kosovës apo të Republikës Federale të Jugosllavisë. Kështu, edhe përkundrejt faktit që selia e tij është në Hagë, themelimi, veprimi, dhe vendim-marrja e Dhomave të Specializuara dhe e Zyres së Specializuar është e bazuar në Kushtetutën dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe në standardet më të larta ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Prandaj, pohimi se “Thaçi do të deklarojë se ndjehet i pafajshëm, meqë vrasja e serbëve dhe e ushtarëve tonë për të nuk është krim,” është në tërësi e pabazuar, meqë është vetë Republika e Kosovës ajo që i ka themeluar Dhomat e Specializara, dhe duke e ndërmarrë këtë veprim, Kosova e ka treguar përgjegjësinë e vet për drejtësinë dhe për krimet e supozuara të luftës. Për më tepër, për çdonjërin të akuzuar vlen parimi i supozimit të pafajsisë, sipas të cilit “Çdo i akuzuar për shkelje penale e ka të drejtën që të merret si i pafajshëm deri sa të mos dëshmohet si fajtor sipas ligjit në një gjykim publik në të cilin i ka patur të gjitha garancat e domosdoshme për mbrojtjen e vet.”¹⁰

⁸ Kosovo parliament approves special war crimes court [Parlamenti i Kosovës e miraton gjykatën speciale të krimeve të luftës], <https://www.bbc.com/news/world-europe-33770897>.

⁹ AMENDMENT OF THE CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF KOSOVO, Amendment no. 24 [AMANDAMENTI I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Amandamenti nr. 24], https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/amendment_of_the_constitution_-_no_24.pdf.

¹⁰ Deklarata Universale e të Drejtave Njerëzore, Neni 11 https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf.

b) Bideni ka qenë për themelimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Artikulli po ashtu parashtrohet akuzë kundër Presidentit të SHBA-ve, Joe Biden, si dhe kundër vendeve Perëndimore, duke pohuar që Perëndimi ata i ka mbrojtur gjatë gjithë kohës, duke aluduar këtu në Thaçin dhe në të pandehurit e tjerë. Ai po ashtu e parashtrohet pyetjen se a do të përpiqet Bideni për ta ndikuar gjykimin e Thaçit, apo të tërë gjykimin. Këto pohime e paraqesin një dezinformate flagrante, meqë, para së gjithash, duhet të vërehet se ishin SHBA-të dhe vendet e BE-së ato që vazhdimisht kishin kërkuar themelimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, dhe ka qenë personalisht Joe Biden ai që i kishte dërguar letër Kryeministrit të atëhershëm dhe të pandehurit të tashëm, Hashim Thaçi, ku ai thoshte se “e inkurajon Kosovën që të bashkëpunojë plotësisht me Bashkimin Evropian për themelimin e Gjykatës Speciale për krimet e luftës.”¹¹ Për më tepër, pas publikimit të akuzës, Departamenti i Shtetit të SHBA-ve ka reaguar duke deklaruar se padia ishte “një hap përpara në procesin e drejtësisë dhe të pajtimit në Ballkanin Perëndimor, që është thelbësor për përparimin e sundimit të ligjit dhe të drejtësisë për viktimat e Kosovës, si dhe për ta lëvizur vendin përtej kësaj periudhe të tmerrshme dhe për t’iu bashkuar komunitetit Euro-Atlantik.”¹² Prandaj, pohimet e tilla në realitet nuk qëndrojnë, por, përkundrazi, janë në tërësi dezinformuese dhe manipuluese.

¹¹ Nënkrjetari i SHBA-ve, letër Kryeministrit Thaçi: Kosova duhet ta themelojë Gjykatën Speciale për krime të luftës <https://balkan.eu.com/vice-president-letter-pm-thaci-kosovo-establish-special-court-war-crimes/>.

¹² Kosovo President Hashim Thaçi Indicted on War Crimes Charges [Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi i Akuzuar për Krime Luftë], <https://www.voanews.com/europe/kosovo-president-hashim-thaci-indicted-war-crimes-charges>.

Lajmërim i Dezinformatës 4

Titulli: Koment i Departamentit për Informim dhe Shtyp për aktivitetet e Dhomave të Specializuara të Kosovës, **Ministria Ruse e Punëve të Jashtme, 9 nëntor 2020**¹³, komentuar nga **Sputnik Serbia**.¹⁴

Ndër të tjera, komenti i Departamentit për Informim dhe Shtyp të Ministrisë Ruse të Punëve të Jashtme, pohon në mënyrë të rrejshme se “E kemi vërejtur faktin që Dhomat e Specializuara të Kosovës të Zyres së Prokurorit Special e kanë bërë një hap përpara në shikimin në krimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe në akuzat kundër udhëheqësve të mëparshëm të këtij entiteti të neveritshëm. Të pandehurit e përfshijnë “Presidentin” Hashim Thaçi, dhe ish “Zëdhënësin e Parlamentit” Kadri Veselin. Është e një rëndësie kritike që të gjithë ata që janë fajtorë për kryerjen e krimeve serioze, e që më parë ishin identifikuar nga Raportuesi i PACE, Dick Marty, të sillen para gjyqit dhe të japin përgjegjësi para ligjit. Në këtë kuptim, nuk bën të ketë njerëz të paprekshëm. “Statusi” mbresëlënës i të akuzuarve është tejet i shquar. Del se për vite të shumta ka patur njerëz në krye të kuazi-shtetit të Kosovës, për të cilët janë grumbulluar dëshmi të fuqishme që i kanë lidhur me veprimtari të paligjshme në Kosovë, përfshirë krime të organizuara dhe terrorizëm”; “Është duke u parë qartë për publikun më të gjerë Perëndimor se kë NATO-ja e ka ndihmuar kur e ka bombarduar Jugosllavinë sovranë në vitin 1999”; ka një kohë të gjatë që Kosova është shndërruar në vatër të ekstremizmit dhe të krimit, madje edhe si një fqinj i BE-së. Arrestimi i dy “qytetarëve” të Kosovës për të cilët policia austriake dyshon se janë të përfshirë në sulmet terroriste të kohëve të fundit në Vjenë, jep dëshmi shtesë për këtë.

¹³ Comment by the Information and Press Department on the Kosovo Specialist Chambers activities [Koment i Departamentit për Informim dhe Shtyp për aktivitetet e Dhomave të Specializuara të Kosovës], https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/-/asset_publisher/cKNonkJE02Bw/content/id/4419121.

¹⁴ Rusija o suđenju Tačiju: Kazniti sve počiniocce zločina na Kosovu [Rusia për gjykimin e Thaçit: Të dënohen të gjithë kryesit e krimeve në Kosovë], <https://rs-lat.sputniknews.com/rusija/202011091123816380-rusija-o-sudjenju-taciju-kazniti-sve-pociniocce-zlocina-na-kosovu/>.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Fillimisht artikulli pohon se “Është e një rëndësie kritike që ata që janë fajtorë për kryerjen e krimeve serioze, të identifikuar më parë nga Raportuesi i PACE, Dick Marty, të sillen para gjyqit ashtu që të japin përgjegjësi para ligjit. Në këtë kuptim, nuk bën të ketë njerëz të paprekshëm. “Statusi” mbresëlënës i të akuzuarve është tejet i shquar,” dhe këto i thotë duke e shpërfillur faktin që Dhomat e Specializuara janë themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës, dhe që me këtë veprim Kosova e ka treguar përgjegjësinë e vet ndaj drejtësisë për krimet e supozuara të luftës. Për më tepër, fakti që ndër të paditurit e parë janë pikërisht Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, dhe anëtari i Kuvendit, Kadri Veseli, tregon se pohimi i Ministrisë Ruse të Punëve të Jashtme është në tërësi manipulues dhe se mund të shihet si një qasje ndërhyrëse ndaj drejtësisë.

Me qëllim që faktori ndërkombëtar dhe Kosova të paraqiten si agresorë, deklarata thotë se “Është duke u bërë e qartë për publikun më të gjerë Perëndimor se kë e ka ndihmuar NATO-ja kur e ka bombarduar Jugosllavinë sovranë në vitin 1999,” duke e shpërfillur faktin thelbësor se fushata e bombardimeve ka qenë rezultat i mizorive të Millosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe refuzimit të tij për ta nënshkruar Marrëveshjen e Rambouillet-së të ndërmjetësuar nga Ambasadori i SHBA-ve, Christopher Hill, i Dërguari i BE-së, Ambasadori Wolfgang Petritsch, dhe Ambasadori rus, Boris Mayorski.¹⁵

Është e rëndësishme të theksohet se para intervenimit të NATO-s, forcat jugosllave tashmë i kishin vrarë 2,000, i kishin ndaluar mbi 1,200, dhe i kishin zhvendosur rreth 300,000 shqiptarë të Kosovës.¹⁶ Të gjitha këto fakte bëhen të qarta dhe evidente në deklaratën e 24 marsit 1999 të Presidentit të SHBA-ve, Clinton, në të cilën ai theksonte se “Ne dhe aleatët tanë të NATO-s jemi duke e ndërmarrë këtë aksion pas përpjekjeve të gjera dhe të përsëritura për të ardhur në një zgjidhje paqësore të krizës në Kosovë,” dhe që sulmet ushtarake i kishin qëllimet në vijim: “ta

¹⁵ Rambouillet Accords: Co-Chairmen's Conclusions [Marrëveshja e Rambouillet-së: Konkluzionet e Bashkë-Kryesuesit, 23 shkurt 1999, https://web.archive.org/web/20070926234216/http://www.ohr.int/other-doc/contactg/default.asp?content_id=3560.

¹⁶ Eric Herring, From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO'S war against Serbia and its aftermath [Nga marrëveshja e Rambouillet-së deri te ajo e Kosovës: Lufta e NATO-s kundër Serbisë dhe më pas] The International Journal of Human Rights, Routledge, tetor 2007.

demonstrojnë vendosmërinë e NATO-s, ta përmbajnë Beogradin nga nisja e ofensivave të reja kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe t'i ulin aftësitë ushtarake të Jugosllavisë për të bërë sulme në të ardhmen.”¹⁷ Së fundi, artikulli pohon se “Kosova ka kohë që është shndërruar në vatër të ekstremizmit dhe të krimit madje edhe si fqinje e BE-së. Arrestimi i dy “qytetarëve” të Kosovës, që policia austriake i dyshon për përfshirje në sulmet terroriste të kohëve të fundit në Vjenë ofron dëshmi shtesë për këtë, duke u përpjekur që të krijohet një ndërlidhje midis luftëtarëve të huaj terroristë nga Kosova dhe sulmeve terroriste të fundit në Vjenë, edhe pse nuk ka ndonjë ndërlidhje të tillë midis tyre. Lidhur me këtë, duhet të vërehen dy çështje: që nga viti 2016 e deri më sot nuk ka qenë asnjë luftëtar i vetëm i jashtëm nga Kosova që ka shkuar në Siri dhe në Irak, dhe, për më tepër, që nga viti 2014, Policia e Kosovës, si dhe institucionet e saj gjyqësore dhe për ndjekje penale, kanë vepruar, dhe në gushtin e vitit 2014, 40 qytetarë kosovarë të dyshuar për pjesëmarrje në veprimtaritë terroriste në Irak dhe në Siri janë arrestuar. Së dyti, institucionet kosovare e kanë dënuar këtë sulm terrorist.¹⁸ Prandaj, ky koment nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme nuk qëndron në asnjërën nga pikat e veta, dhe është në tërësi manipulativ.

¹⁷ CNN: NATO Attack on Yugoslavia begins [Sulmi i NATO-s kundër Jugosllavisë fillon], 24 mars 1999, <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9903/24/kosovo.strikes/>

¹⁸ Kryeministri Hoti letër Kancelarit Kurz: I dënojmë fuqishëm sulmet terroriste në Vjenë, <https://kryeministri-ks.net/kryeministri-hoti-leter-kancelarit-kurz-i-denojme-fuqishem-sulmet-terroriste-ne-vjene/>.

Lajmërim i Dezinformatës 5

Titulli: Dva opasna zakona protiv Srba: Samo Beograd ne tera druge narode na svoju verziju istorije [Dy ligje të rrezikshme kundër serbëve: Beogradi i vetmi që nuk i shtyn popujt e tjerë kah verzioni i vet i historisë], **Sputnik Serbia, 27 nëntor 2020.**¹⁹

Artikulli i komenton deklaratat e bëra nga Dragomir Angjellković lidhur me Ligjin për Vlerat e Luftës së UÇK-së në Kosovë, dhe Ligjin për Ndalimin e Mohimit të Gjenocidit në Bosnje e Hercegovinë. Ndër të tjera, Dragomir Angjellković pohon: “E vërteta është në anën tonë, dhe krimet janë në anën e tyre. Ne nuk kemi ligje që do ta impononin njohjen e gjenocidit që është kryer kundër popullit serb, meqë e vërteta dihet. Nuk ka dyshim se gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër serbëve është kryer gjenocid, ne pa dyshim ishim viktimat më të mëdha të Luftës së Parë Botërore, dhe ne pa dyshim i ishim nënshtruar persekutimeve dhe pogromeve masive gjatë luftrave të viteve 1990. Kështu, e tërë kjo e vërtetë e madhe vjen në sipërfaqe nga vetvetja, pavarësisht nga ajo se sa shumë përpiqet dikush ta fshehtë atë.” Artikulli më tutje pohon se Serbia i ka arrestuar kriminelët e vet: “Ne kemi luftuar lufta defansive dhe ne i kemi arrestuar dhe ndjekur penalisht kriminelët tanë. Dhe ne jemi të gatshëm të vazhdojmë ta bëjmë këtë, dhe kjo është pse ne nuk kemi nevojë për ligje të posaçme që do t’i mbronin qytetarët tanë që kanë kryer krime.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Mohimi i krimeve të luftës që Serbia i ka kryer në Kosovë

Artikulli e synon minimizimin dhe fshehjen e krimeve të luftës të kryera nga forcat policore, ushtarake, dhe paramilitare serbe gjatë luftrave në Kosovë dhe në Bosnje, si dhe barazimin e viktimës me agresorin. Në këtë rast konkret, artikulli përpiqet që serbët t’i paraqesë rrejshëm si viktima, edhe pse është një fakt i njohur mirë që serbët ishin agresorë dhe i shkaktuan luftrat në

¹⁹ Dva opasna zakona protiv Srba: Samo Beograd ne tera druge narode na svoju verziju istorije [Dy ligje të rrezikshme kundër serbëve: Beogradi i vetmi që nuk i shtyn popujt e tjerë kah verzioni i vet i historisë], <https://rs-lat.sputniknews.com/analize/202011271123963921-dva-opasna-zakona-protiv-srba-samo-beograd-ne-tera-drug-narode-na-svoju-verziju-istorije-//>.

Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, dhe Kosovë. Gjatë këtyre luftëve, forcat ushtarake, policore, dhe paramilitare serbe kanë kryer gjenocid²⁰ dhe krime të luftës kundër kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve.

Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 konsiderohet si një vepër e gjenocidit dhe krim i luftës nga Tribunali Ndërkombëtar Kriminal për ish Jugosllavinë (ICTY), meqë më shumë se 7000 burra dhe djem boshnjakë janë ekzekutuar në rrjedhën e disa ditëve nga trupat serbe, gjë kjo që e paraqet rastin më të rëndë të vrasjeve masive në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.²¹ Po ashtu, gjatë konfliktit të vitit 1999, raporti i The Human Rights Watch ka dokumentuar se në Kosovë ka pasur “torturime, vrasje, përdhunime, dëbime me forcë, dhe krime të tjera të luftës të kryera nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave kundër shqiptarëve kosovarë midis 24 marsit dhe 12 qershorit 1999.” Për më tepër, raporti po ashtu e ka shpalosur “një fushatë të koordinuar dhe sistematike për t’i terrorizuar, vrarë, dhe dëbuar shqiptarët etnikë të Kosovës, që është organizuar nga nivelet më të larta të qeverive serbe dhe jugosllave në pushtet në atë kohë.”²² Më konkretisht, bazuar në burimet e ndryshme, Raporti ka përfunduar se “përafërsisht 10,500 shqiptarë kosovarë janë vrarë midis 20 marsit dhe 12 qershorit 1999, ku intervali i besueshmërisë ishte 95 përqind në brezin prej 7,449 deri në 13,627.” Pos kësaj, sipas raportit, “ushtria jugosllave dhe policia dhe paramilitarët serbë i kanë dëbuar 862,979 shqiptarë nga Kosova, dhe disa qindra mijëra të tjerë kanë qenë të zhvendosur të brendshëm. Këto shifra tregojnë se në fillimin e qershorit 1999, më shumë se 80 përqind e të tërë popullatës së Kosovës, dhe 90 përqind e shqiptarëve kosovarë, kanë qenë të zhvendosur nga shtëpitë e tyre.”²³

²⁰ Shih Sabrina Ramet, *The Three Yugoslavias: State-Building and Legitimation 1918-2005* [Tri Jugosllavitë: Shtet-Ndërtimi dhe Legitimimi 1918–2005], Washington, D.C.: Indiana University Press. 2006, fq. 459-460.

²¹ Srebrenica massacre [Masakra e Srebrenicës], <https://www.britannica.com/event/Srebrenica-massacre>.

²² “Under Orders: War Crimes in Kosovo [Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë],” Raport i Human Rights Watch, 2001, <https://www.hrw.org/report/2001/10/26/under-orders/war-crimes-kosovo>.

²³ Ibid.

b) Serbët nuk janë marrë në përgjegjësi për krimet e kryera

Pjesa e dytë e artikullit pohon se Serbia i ka arrestuar dhe ndjekur penalisht kriminelët e vet, dhe që është e gatshme të vazhdojë ta bëjë këtë edhe më tutje, dhe se kjo është ajo pse Serbia nuk ka nevojë për ligje të posaçme që do t'i mbronin qytetarët e saj që kanë kryer krime. Në të vërtetë, ky pohim në realitet nuk qëndron fare, dhe është në tërësi dezinformues. Gjatë periudhës 1999–2018, institucionet e drejtësisë në Kosovë i kanë akuzuar për krime lufte 111 veta, nga të cilët 61 ishin shqiptarë, 44 serbë, 5 malazezë dhe 1 ishte rom. Nga 61 shqiptarët e paditur, 34 janë dënuar, 23 janë liruar, 2 janë në arrati, dhe 2 janë ende në procedura juridike. Nga 44 serbët e paditur, 4 janë dënuar, 13 janë liruar, dhe 24 janë në arrati.²⁴ Nga ana tjetër, institucionet serbe të drejtësisë, për krimet e kryera në Kosovë deri më tash i kanë dënuar 17 serbë, që gjatë luftës ishin ushtarë ose policë, por pothuaj asnjëri prej tyre nuk i takonte hierarkisë komanduese, ndërkohë që Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në Jugosllavi i ka dënuar gjashtë përfaqësues të lartë serbë.²⁵

Lidhur me këtë, duhet të vërehet se pas përfundimit të mandatit të Tribunalit Ndërkombëtar Kriminal për ish Jugosllavinë, Kombet e Bashkuara e kanë themeluar Mekanizmin Ndërkombëtar Rezidual për Tribunalet Kriminale.²⁶ Mekanizmi i obligon shtetet e ish Jugosllavisë t'i ndjekin penalisht personat e dyshuar për krimet kundër njerëzimit në gjykatat lokale.²⁷

²⁴ An Overview of the War Crimes Trials in Kosovo: 1999 – 2018 [Vështrim i Gjykimeve për Krimet e Luftës në Kosovë: 1999 – 2018], Humanitarian Law Center [Qendra për të Drejtën Humanitare], tetor 2018, <http://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/10/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf>.

²⁵ Blakaj: Në Kosovë për krime lufte janë dënuar gjashtë serbë, në Serbi për krime të kryera në Kosovë janë dënuar 15 serbë, Telegrafi, 15 mars 2019, <https://telegrafi.com/blakaj-ne-kosove-per-krime-lufte-jane-denuar-gjashte-serbe-ne-serbi-per-krime-te-kryera-ne-kosove-jane-denuar-15-serbe-video/>.

²⁶ International Residual Mechanism for Criminal Tribunals [Mekanizmi Ndërkombëtar Rezidual për Tribunalet Kriminale]: <https://www.irmct.org/en/about>.

²⁷ Statute of the International Residual Mechanism for Criminal Tribunals [Statuti i Mekanizmit Ndërkombëtar Rezidual për Tribunalet Kriminale], Neni 6, https://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/ResidualMechanism/101222_sc_res1966_residualmechanism_en.pdf?fbclid=IwAR199bMnI4zwmmdmFeEmTbzAHT9jjuBJ65K4jcvrm2Mjzb2S7dIN4v3QyFWc.